VENDIM
Nr. 814, datë 16.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 337, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimet:

a) "njësi e qeverisjes vendore" zëvendësohen me "bashkia";

b) "këshilli i njësisë së qeverisjes vendore" zëvendësohen me "këshilli bashkiak".

2. Shkronja "a", e pikës 1, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"a) Kryetari i bashkisë afishon në vendet publike të bashkisë e të njësisë administrative dhe boton në gazetën e pushtetit vendor apo në njërën nga gazetat e përditshme vendore ose kombëtare lajmërimin publik të paraqitjes së dokumentacionit, sipas pikave 2 e 3, të këtij vendimi, për të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP), sipas përcaktimeve të nenit 2, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", në se ky lajmërim nuk është bërë më parë për gjithë territorin e bashkisë apo për njësi administrative të veçanta;".

3. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshon, me këtë përmbajtje:

"2. Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, jo më vonë se 3 muaj, nga përfundimi i afatit ligjor të plotësimit të dokumentacionit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:".

4. Paragrafi i pare, i pikës 3, ndryshon me këtë përmbajtje:

"3. Subjektet e përcaktuara si bashkëthemeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, jo më vonë se 3 muaj, nga përfundimi i afatit ligjor të plotësimit të dokumentacionit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:".

5. Pika 14 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"14. Këshilli bashkiak, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përcakton me vendim, të marrë në përputhje me pikën 4, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", emrat e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore për çdo fshat në bashki si dhe emrat e subjekteve përfituese, që plotësojnë kushtet ligjore për t'u pajisur me AMTP, vendndodhjen e tokës, sipërfaqen, kufizimet dhe kufitarët për çdo ngastër, të shoqëruar me hartën kadastrale, si pjesë përbërëse të tij, dhe me relacion të hollësishëm.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama